



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:116328

Datë: 14.06.2024

Numri i dokumentit: 05826018

KE.nr. 338/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit/propozuesit të masës së sigurimit ARENA CHANNELS GROUP D.O.O., me seli në Beograd, Republika e Serbisë, me NUI: 20510293, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fatos Zeqiri, avokat nga Prishtina, ndaj të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit T.C. B.I., me emër tregtar “P.P. KDS TELESTAR IC”, me NUI:810208604, me seli në Ropotovë e Vogël, Komuna e Kamenicës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Mustafë Musa, avokat nga Gjilani, duke vendosur sipas padisë dhe propozimit për caktimin e masës së sigurimit, pas mbajtjes së seancës dëgjimore të datës 04.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE në pikëpamje gjyqësore, për të vendosur sipas padisë dhe propozimit për caktimin e masës së sigurimit të paditësit/propozuesit të sigurimit “Arena Channels Group” D.O.O, me seli në Beograd, Republika e Serbisë, me numër të lëndës KE.nr. 338/24 (2024:116328), kundër të paditurit/kundërshtarit të sigurimit T.C. B.I., me seli në Shtërpcë, Republika e Kosovës, në çështjen juridike me objekt kontesti mbrojtja e së drejtës së autorit.
- II. SHPALLEN TË PAVLEFSHME të gjitha veprimet procedurale të kryera nga ana e gjykatës në këtë çështje kontestimore.
- III. HEDHET POSHTË si e palejuar padia dhe propozimi për caktimin e masës së sigurimit i paraqitur nga paditësi/propozuesi i sigurimit “Arena Channels Group” D.O.O., me seli

në Beograd, Republika e Serbisë, me datë 19.04.2024, me shenjë KE.nr.338/24 (2024:116328), kundër të paditurit/kundërshtarit të sigurimit T.C. B.I., me seli në Shtërpçë, Republika e Kosovës, me objekt kontesti mbrojtja e së drejtës së autorit.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi/propozuesi i masës së sigurimit ARENA CHANNELS GROUP D.O.O., përmes të autorizuarit të tij, me datën 19.04.2024, ka paraqitur padi me propozim për caktimin e masës së sigurimit, ndaj të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit T.C. B.I., me të cilën ka kërkuar që të aprovet në tërësi kërkesëpapia e paditësit dhe të vërtetohet se e padituri ka shkelur të drejtën autoriale të paditësit duke transmetuar programet audio vizuale të kanaleve Arena Sport 1, Arena Sport 2, Arena Sport 3, Arena Sport 4, Arena Sport 5, Arena Premium 1, Arena Premium 2 dhe Arena Premium 3, pa lidhur marrëveshje mbi të drejtat autoriale të paditësit; të detyrohet i padituri që të ndaloj shpërndarjen e programeve audio vizuale të kanaleve të lartcekura si dhe të mos përsëris shpërndarjen e të njëjtëve në të ardhmen, pa lidhur marrëveshje mbi të drejtat autoriale me paditësin; të detyrohet i padituri t'ia kompensoj dëmin material dhe fitimin e humbur të shkaktuar si pasojë e shpërndarjes së programeve audio vizuale pa marrëveshje mbi të drejtat autoriale me paditësin; të urdhërohet Radio Televizioni i Kosovës që vendimin ta shpall në rubrikën për shpallje zyrtare, me shpenzimet e të paditurit, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur vendimi të marr formën e prerë, si dhe të detyrohet i padituri që paditësit të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore.

Me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit ka kërkuar që të detyrohet i padituri/kundërshtari i sigurimit që të ndërpres shpërndarjen e programeve audio vizuale të kanaleve televizive Arena Sport 1, Arena Sport 2, Arena Sport 3, Arena Sport 4, Arena Sport 5, Arena Premium 1, Arena Premium 2 dhe Arena Premium 3 dhe të ndalojë përsëritjen e shpërndarjes së këtyre programeve audio vizuale pa marrëveshje me paditësin në të ardhmen.

I padituri/kundërshtari i sigurimit, përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 27.05.2024, ka paraqitur përgjigje në padi dhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit me të cilën ka kundërshtuar kompetencën lëndore të kësaj gjykate për shkak se konform nenit 28 të LPK-së, gjykata e vendit është kompetente vetëm nëse kompetenca e saj rezulton shprehimisht nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare ose nga vet ligji e në rastin konkret nuk përmbushet asnjëri nga kushtet e caktuara. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pabazuar padinë dhe propozimin për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata, me datë 04.06.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore lidhur me caktimin e masës së sigurimit në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqëse.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit/propozuesit të masës së sigurimit avokati Fatos Zeqiri, gjatë seancës dëgjimore ka deklaruar se qëndron pranë propozimit për caktimin e masës së sigurisë duke theksuar se janë plotësuar të dy kushtet e parapara me nenin 297, par.1 pika a) dhe b) të LPK-së, sepse propozuesi e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës dhe të drejtës së tij subjektive, kjo ngase i njëjti mban të drejtën autoriale të kanaleve dhe kontetit Arena Sport 1, Arena Sport 2, Arena Sport 3, Arena Sport 4 dhe Arena Sport 5, Arena Premium 1, Arena Premium 2, dhe Arena Premium 3.

Më tutje, ka deklaruar se paditësi/propozuesi i sigurimit është pronar i kanaleve të lartcekura sipas certifikatave të regjistrimit në emër të propozuesit. Ka shtuar se palët e treta kanë të drejtën e transmetimit të këtyre kanaleve vetëm në rast se kanë marrëveshje të shkruar, duke theksuar se paditësi/propozuesi i sigurimit ka marrëveshje me dy operator vendor për shpërndarjen e kanaleve dhe kontetit dhe përmes kësaj marrëveshje ka autorizuar këta operator që të bëjnë shpërndarjen e programeve audio vizuale përmes platformave të tyre, ndërsa kundërshtari i sigurimit në vazhdimësi është duke bërë transmetimin e këtyre kanaleve pa pasur asnjë marrëveshje me propozuesin, e në këtë mënyrë i ka shkaktuar kështu dëm propozuesit edhe në lidhje me marrëveshjet që ka me operatorët tjerë. Ka shtuar se në rastin konkret plotësohet edhe kushti i dytë, përkatësisht ekzistimi i rrezikut, sepse nëse nuk vendohet masa e sigurisë atëherë kundërshtari i sigurimit do të vazhdoj të bëjë transmetimin e kanaleve pa marrëveshje dhe pa kompensim.

Sa i përket përgjigjes së paraqitur nga kundërshtari i sigurimit, ka deklaruar se Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, kanë kompetence lëndore bazuar në nenin 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo edhe për faktin se kundërshtari i sigurimit është shoqëri tregtare në bazë të LSHT-së, dhe se kjo gjykate ka juridiksion në tërë territorin e RKS-së. Sa i përket pretendimit në përgjigje se kemi njëjtësi të kërkesëpadisë me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, ka deklaruar se ky pretendim nuk qëndron pasi që me padi është kërkuar vërtetimi se kundërshtari i sigurimit në mënyrë të kundërligjshme ka bërë transmetimin e kanaleve që janë pronë e propozuesit. Gjykatës i ka propozuar që masa e sigurimit të caktohet në përputhje me nenin 185 të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat tjera të Përafërta, ku parashihet ndalimi i shkeljeve të pritura apo ndalimi i vazhdimit të kryerjes se shkeljes së supozuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit në përgjigjen me shkrim si dhe gjatë seancës dëgjimore ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaramëve me shkrim duke kundërshtuar në tërësi propozimin për caktimin e masës së sigurimit dhe kompetencën lëndore, nga fakti se pala paditëse është person juridik i shtetit tjetër i cili nuk e njeh Republikën e Kosovës, dhe nuk ju ofron ndihmë juridike as personave fizik që lajmërohen me nënshtetësinë e Republikës së Kosovës dhe as personave juridik, e po ashtu edhe dispozita e nenit 196 e Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, parasheh se Gjykatat e Republikës së Kosovës mund të ju ofrojnë mbrojtje personave me shtetësi të huaj, po që se një gjë e tillë parashihet me marrëveshje ndërkombëtare apo ligjin e lartcekur, apo nëse ekziston reciprociteti faktik, çka në rastin konkret nuk ekziston asnjëra prej varianteve të lartcekura.

Më tutje, ka shtuar se në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet sipas dispozitës se nenit 297 par. 1 pika a) të LPK-së, pasi që propozuesi i sigurimit nuk ka arritur ta bëjë të besueshme të drejtën e tij, nga fakti se e padituri asnjëherë nuk ka bërë transmetimin e kanaleve të paditësit, andaj meqë i padituri nuk shfrytëzon shërbimet e paditësit atëherë nuk mund të vije në shprehje as kurrfarë rreziku që pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të pamundësonte apo vështirësonte realizimin e kërkesës së saj. Po ashtu, ka theksuar se në rastin konkret kërkesës lidhur me caktimin e masës së përkohshme të sigurimit është identike me formulimin e kërkesëpadisë dhe nëse eventualisht caktohet masa e sigurimit, me të njëjtën do të zgjidhej edhe çështja kryesore sipas kërkesëpadisë. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj propozimin për caktimin e masës së sigurisë dhe të aprovohen kundërshtimet e kundërshtarit të masës së sigurimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit të padisë, propozimit për caktimin e masës së sigurimit dhe shkresave të lëndës, në përputhje me nenin 17.1 dhe 18.1 të LPK-së, vlerësoi kompetencën e Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk ka kompetencë gjyqësore për të vendosur në këtë çështje, për shkaqet si në vijim:

Sipas neni 138.1 të Ligjit Nr. 08/L-205 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta përcaktohet se: *“Personat e huaj fizikë ose juridikë gëzojnë të njëjtën mbrojtje të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, sikurse personat vendas, nëse këtë e parashikojnë marrëveshjet ndërkombëtare ose ky ligj, ose nëse ekziston reciprociteti faktik.”* Ndërsa me nenin 143 të po të njëjtit ligj përcaktohet se: *“Reciprociteti duhet të provohet nga personi që i referohet”*.

Bazuar në dispozitat e cituara më lartë, kjo Gjykatë vlerëson paditësi/ propozuesi i sigurimit lidhur me të drejtën e pretenduar, nuk mund të kërkojë mbrojtje juridike pranë kësaj Gjykate, pasi që i njëjti nuk ka provuar reciprocitetin faktik, përkundër që kjo është barrë e tij në kuptim të nenit 143 të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Andaj, duke qenë se paditësi është shoqëri tregtare e regjistruar sipas legjislacionit serb dhe se selia e tij është në Beograd, Republika e Serbisë, shtet ky me të cilin Republika e Kosovës nuk ka ndonjë marrëveshje ndërkombëtare, ndërsa në anën tjetër paditësi nuk ka provuar reciprocitetin faktik, rrethana këto të cilat determinojnë edhe kompetencën e kësaj Gjykate, atëherë rrjedhë se paditësi nuk mund të gëzojë mbrojtje gjyqësore në raport me pretendimet për shkeljen e së drejtës së autorit sipas Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe rrjedhimisht gjykata duhet të shpallet jokompetente, ndërsa propozimi për caktimin e masës së sigurimit dhe padia duhet të hedhen si të palejuara.

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 18.1 të LPK-së, e cila përcakton që: *“Gjykata, sipas detyrës zyrtare, gjatë gjithë procedurës kujdeset nëse zgjidhja e kontestit hynë ose jo në kompetencën gjyqësore”*, lidhur nenin 391 pika a) përcakton: *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: a) çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore”*, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës sikurse në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata e mbështeti në nenin 450 të LPK-së, i cili përcakton se “*Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta*”, lidhur me nenin 463.1 me të cilin parashihet se “*Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën*”.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.338/24, datë 04.06.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.